RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0089/23
Data 25.09.2023
PRISHTINË

RTK

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË RTK-së

Prishtinë, Shtator 2023

BORDI I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS

Në bazë të Nenit 29, par. 2 dhe nënparagrafit 2.2 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) Nr. 04/L-046, si dhe Nenit 17, par. 2, nënpararagrafit 2, të Statutit të Radio Televizionit të Kosovës, Bordi i Radio Televizionit të Kosovës, nxjerr:

RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË RTK-SË

Neni 1
Fushëveprimi

Me këtë Rregullore, përcaktohet mënyra e punës dhe e vendimmarrjes së Bordit të RTK-së (në tekstin e mëtejshëm Bordi), si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e tij. Bordi i RTK-së punon dhe vepron sipas Ligjit për RTK-në Nr. 04/L-046, sipas Statutit të RTK-së si dhe sipas rregullativës ligjore të Republikës së Kosovës. Përbërja e Bordit, zgjedhja e anëtarëve të Bordit, pamundësia për të qenë anëtar i Bordit, shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit, kompetencat e bordit, dhe çështje të tjera që definojnë punën e Bordit të RTK-së, rregullohen sipas Ligjit për RTK-në Nr. 04/L-046 si dhe sipas akteve nënligjore që rregullojnë punën dhe aktivitetin e Radiotelevizionit të Kosovës si transmetues publik. Emërtimet në këtë rregullore jane neutrale sa i përket gjinisë.

Neni 2
Parimet

1. Bordi i përfaqëson interesat e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës;
2. Asnjë anëtar i Bordit nuk pranon instruksione nga jashtë që do të ndikonte në pavarësinë e punës së tij;
3. Çdo anëtar i Bordit duhet ta kryejë punën e tij me nder, përkushtim dhe përgjegjësi konform Ligjit dhe Statutit të RTK-së, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera në Republikën e Kosovës;
4. Anëtari i Bordit ka të drejtë për qasje në të gjitha informacionet lidhur me çështjet për të cilat ai duhet të vendosë dhe të cilat ai i mbikëqyr konform Ligjit dhe Statutit të RTK-së.

Neni 3
Veprimtaria dhe mënyra e punës së Bordit të RTK-së

1. Anëtari më i vjetër i Bordit të ri të RTK-së e konvokon mbledhjen e parë të Bordit të RTK-së sa më parë që është e mundur, e më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e emërimit të anëtarëve të Bordit;
2. Bordi i RTK-së konsiderohet se është konstituuar nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit;
3. Kryetari i Bordit të RTK-së, të paktën një herë në muaj, thërret mbledhjet e rregullta të këtij Bordi.
4. Mbledhjet e Bordit të RTK-së mund të konvokohen edhe me kërkesën e së paku pesë (5) anëtarëve të Bordit. Sipas nevojës mbledhjet e Bordit mund të konvokohen edhe më shpesh;
5. Kuorumi i mbledhjeve të Bordit të RTK-së është gjashtë (6) anëtarë;
6. Mbledhjet e Bordit i udhëheq kryetari në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e punës së Bordit të RTK-së;
7. Në mungesë të kryetarit të Bordit, mbledhjet i udhëheq nënkryetari i tij;

8. Gjatë procesit të punës dhe vendimmarrjes, në Bordin e RTK-së, votimi është i hapur, përveçse në rastet kur parashihet ndryshe shprehimisht;
9. Bordi i RTK-së sipas Ligjit për RTK-së është i detyruar që për punën e vet t'i raportojë themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme;
10. Raportimi i rregullt i Bordit për punën e tij bëhet në mënyrë periodike – njëherë në çdo tre (3) muaj dhe në fund të çdo viti. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së themeluesit;
11. Në mbledhjen e parë, Bordi i RTK-së, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij nga radha e anëtarëve të Bordit; nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit;
12. Votimi për zgjedhjen e kryetarit të bordit, bëhet me vota të fshehta;
13. Jo më shumë se dy (2) herë, anëtarët e Bordit mund të propozojnë dhe votojnë kandidatin e njëjtë për kryetar dhe/ose nënkryetar të bordit;
14. Drejtori i përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit të RTK-së si anëtar pa të drejtë vote. Në mungesë të tij, Drejtori i Përgjithshëm mund të autorizojë një anëtar të menaxhmentit të lartë që të marrë pjesë në mbledhje;
15. Bordi i RTK-së, sipas nevojës mund të kërkojë që në mbledhjet e tij të marrin pjesë edhe anëtarët tjerë të menaxhmentit të lartë të RTK-së si dhe punonjës të tjerë në prani ose autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm;
16. Bordi i RTK-së mund të mbajë takime në distancë (online), ose takime të kombinuara (duke pasur anëtarë që mblidhen fizikisht dhe anëtarë që marrin pjesë virtualisht (online) nga distanca).
17. Bordi i RTK-së mund të votojë në mënyrë të hapur gjatë takimeve fizike, në mënyrë të hapur gjatë takimeve në distancë (online) ose me votë qarkulluese përmes postës elektronike zyrtare të RTK-së. Votimi duhet të bëhet brenda datës së njëjtë kur është dërguar propozimi.
18. Sekretaria e Bordit të RTK-së koordinohet nga Asistenti Administrativ i Bordit
19. Zyrtari Ligjor i caktuar të asistojë në mbledhjet e Bordit, merr pjesë në mbledhje të Bordit, me ftesë nga Bordi.

Neni 4
Detyrat e kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit

1. Kryetari i Bordit është përgjegjës për udhëheqjen dhe përfaqësimin e Bordit.
2. Për t'i përmbushur përgjegjësitë e tij, kryetari i Bordit:
   a) Siguron udhëheqjen e Bordit konform akteve ligjore dhe nënligjore;
   b) Bën konsultimet e nevojshme me anëtarët e tjerë të Bordit lidhur me mbledhjen pasuese dhe me aktivitetet e tjera të Bordit.
   c) Merr pjesë dhe kryeson mbledhjet, duke u siguruar se të gjithë anëtarëve të Bordit u është dhënë mundësia për të shprehur pikëpamjet e tyre;
   d) Sigurohet që të gjithë anëtarët të pranojnë informata të sakta, të qarta dhe me kohë;
   e) Vepron së bashku me Sekretarinë e Bordit për çështje që kanë të bëjnë me organizimet e mbledhjeve, agjendat, raportet dhe dokumentet e Bordit, si dhe procesverbalet e mbledhjeve;
   f) Vepron si pikë kontakti ndërmjet Bordit dhe themeluesit;
   g) Vepron si pikë kontakti ndërmjet Bordit dhe drejtorit të përgjithshëm të RTK-së;
   h) Informon bordin lidhur me aktivitetet që i ka në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive.
   i) Në mungesë të kryetarit apo me autorizimin e tij, detyrat e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni kryhen nga nënkryetari;
   j) Kryetari i Bordit përkujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të marra nga Bordi;

Neni 5
Mbledhjet e Bordit

1. Konform Nenit 38 të Ligjit për RTK-në, veprimtaria e RTK-së është publike.
2. Mbledhjet e Bordit konvokohen nga kryetari i Bordit.
3. Mbledhja e Bordit mund të konvokohet edhe me kërkesën e së paku 5 anëtarëve.
4. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së mund t'i propozojë Bordit mbajtjen e mbledhjeve për çështje të caktuara.
5. Bordi i RTK-së mban një mbledhje të rregullt mujore, mbledhje të jashtëzakonshme ose jo të planifikuara për sa herë të jetë e nevojshme;
6. Me rastin e konvokimit të mbledhjeve të rregullta të Bordit, Sekretaria e Bordit obligohet që së paku tri ditë përpara datës së caktuar për mbledhje, të dërgojë tek anëtarët e Bordit materialet përkatëse dhe agjendën e mbledhjes, e cila përmban datën, vendin dhe kohën e saktë të mbajtjes së mbledhjes.
7. Me rastin e konvokimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme të përshkruara në paragrafin 6 të këtij neni, anëtarëve të Bordit duhet t'u dërgohet agjenda bashkë me arsyen e konvokimit të mbledhjes si dhe materialet e nevojshme para takimit.
8. Pika e parë në agjendën e mbledhjeve të rregullta duhet të jetë gjithmonë aprovimi i procesverbaleve të mbledhjeve paraprake.
9. Agjenda e mbledhjes miratohet me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.
10. Anëtarët e bordit mund të propozojnë përfshirjen e pikave në agjendë.
11. Bordi para marrjes së vendimit duhet që të konstatojë kuorumin e domosdoshëm. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe plotfuqishmëria e vendimeve të Bordit është vetëm me shumicën e votave të përtej gjysmës së anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Bordit, nëse nuk përcaktohet ndryshe me Ligjin për RTK-në.
12. Votimet në mbledhjet e Bordit janë të hapura, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me Ligjin e RTK-së.
13. Mbledhjet fizike të Bordit janë të hapura për monitorim nga çdo palë e interesuar, përveç rasteve kur për shkak të mbrojtjes së informacionit për të dhëna personale dhe të dhënave tjera të ndjeshme, Bordi vendos t'i mbyllë ato në tërësi apo në pika të caktuara të agjendës.
14. Palët e interesuara për monitorim, duhet ta njoftojnë Sekretarinë e Bordit për pjesëmarrje në monitorim para fillimit të mbledhjes për çështje logjistike.
15. Sekretaria e Bordit njofton palët e interesuara për monitorim nëse mbledhja është e hapur apo jo, nëse mbledhja ka pika të cilat do të mbyllen dhe nëse mbledhja mund të monitorohet në tërësi.
16. Njoftimet dhe agjenda për mbledhjet e ardhshme të Bordit të RTK-së publikohen në ueb-faqen zyrtare të RTK-së, në ditën e njëjtë kur ftohen edhe vet anëtarët e Bordit të RTK-së.
17. Varësisht nga agjenda e Bordit dhe nga nevojat specifike për informacione shtesë dhe mbështetëse, Bordi mund të ftojë edhe persona të tjerë që nuk janë pjesë e RTK-së. Pjesëmarrja e personave të tjerë është e kufizuar vetëm për pjesën e mbledhjes për të cilën ata ftohen.
18. Zyrtari Ligjor i caktuar të asistojë Bordin e RTK-së merr pjesë në mbledhjet e Bordit të RTK-së, përveç se në rastet kur kërkohet ndryshe nga Bordi i RTK-së.

Neni 6
Procesverbali nga mbledhja e Bordit

1. Procesverbali i miratuar nga Bordi i RTK-së është dokument zyrtar nga i cili dalin vendimet e Bordit të RTK-së;
2. Mbledhjet e Bordit të RTK-së mund të regjistrohen tonikisht nëse për këtë paraprakisht merret vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, kjo për arsye të lehtësimit të procedurës për përpilimin e procesverbalit, por edhe në rast të nevojës për ruajtjen e materialeve.
3. Procesverbali duhet të përmbajë:

a) Vendin, datën dhe kohën kur ka filluar mbledhja e bordit;
b) Emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të Bordit dhe personave të tjerë të ftuar dhe të pranishëm në mbledhje, duke evidentuar praninë e tyre gjatë gjithë mbledhjes;
c) Për secilën pikë të diskutimit në rast të votimit, duhet të specifikohet se kush ka votuar "Për" dhe kush "Kundër".
d) Konstatimin e kuorumit;
e) Miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
f) Pikat e rendit të ditës;
g) Vendimet dhe mënyrën e votimit në mbledhje;
h) Rezultatet e votimit.
i) Të ndryshme.

4. Nëse ndonjë anëtar i bordit ka mendim ndryshe apo të kundërt për çështjet e dakorduara, ai ka të drejtë të sigurohet se deklarimi i tij është përfshirë tërësisht në procesverbal;
5. Procesverbali mbahet dhe përgatitet nga Asistenti Administrativ i Bordit, dhe dërgohet tek Bordi për rishikim dhe aprovim;
6. Procesverbali pas rishikimit nga Bordi, dërgohet edhe tek Drejtori i Përgjithshëm;
7. Procesverbali i miratuar nga anëtarët pjesëmarrës në takim, nënshkruhet nga Kryetari apo Nënkryetari i Bordit (varësisht se cili e ka kryesuar mbledhjen) dhe ruhet në dosjen e procesverbaleve nga sekretaria e Bordit;
8. Pas nënshkrimit të procesverbalit nga Kryetari apo Nënkryetari, Asistenti Administrativ ua dorëzon nga një kopje çdo anëtari të Bordit dhe Drejtorit të Përgjithshëm, përmes postës zyrtare elektronike.

Neni 7
Organet që veprojnë në kuadër të Bordit të RTK-së

1. Organet qe veprojnë në kuadër të Bordit të RTK-së janë:

1.1. Sekretaria e Bordit;
1.2. Grupi Këshillues i Publikut;
1.3. Njësia e Auditimit të Brendshëm;
1.4. Komiteti i Auditimit të Brendshëm;

Neni 8
Sekretaria e Bordit të RTK-së

1. Sekretaria e Bordit të RTK-së koordinohet nga Asistenti Administrativ i Bordit dhe asistohet nga Zyrtari Ligjor i caktuar nga Zyra Ligjore e RTK-së.

1.1. Asistenti Administrativ i Bordit të RTK-së:
1.1.1. Është pozicion i rregullt në RTK në kuadër të strukturës organizative, në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore;
1.1.2. Rekrutohet me konkurs apo caktohet sipas rregullativës së brendshme nga menaxhmenti i RTK-së;
1.1.3. Lidh marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës dhe rregulloreve të brendshme të RTK-së që rregullojnë marrëdhënien e punës me punëtorët e rregullt të RTK-së.

1.2. Përgjegjësitë e Asistentit Administrativ të Bordit të RTK-së përfshijnë organizimin administrativ të mbledhjeve të Bordit të RTK-së, si:
1.2.1. Ftesa dhe agjenda për mbledhjet e Bordit të RTK-së;

1.2.2. Koordinimi i pjesëmarrjes së monitoruesve në mbledhjet e Bordit të RTK-së;
1.2.3. Sigurimi i hapësirës në sallën e mbledhjeve për pjesëmarrësit dhe monitoruesit;
1.2.4. Marrja e porosive si dhe dërgimi i porosive në adresë të dhe në emër të Bordit të RTK-së;
1.2.5. Protokollimi dhe ruajtja e të gjitha dokumenteve në kuadër të Bordit të RTK-së;
1.2.6. Mbajtja e procesverbalit në mbledhjet e Bordit të RTK-së;
1.2.7. Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara nga Bordi.

1.3. Zyrtari Ligjor i caktuar të asistojë në Bordin e RTK-së:
1.3.1. Është pozicion i rregullt në RTK në kuadër të strukturës organizative, në Departamentin Ligjor të RTK-së;
1.3.2. Rekrutohet me konkurs apo caktohet sipas rregullativës së brendshme nga menaxhmenti i RTK-së;
1.3.3. Lidh marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës dhe rregulloreve të brendshme të RTK-së që rregullojnë marrëdhënien e punës me punëtorët e rregullt të RTK-së.

1.4. Përgjegjësitë e Zyrtarit Ligjor të caktuar për asistencë ndaj Bordit të RTK-së janë:

1.4.1. Këshillimi i Bordit të RTK-së rreth kornizës ligjore aktuale të Republikës së Kosovës, ndryshimet e pritshme dhe ndryshimet që ndodhin;
1.4.2. Këshillimi ligjor i Bordit për të gjitha pikat e agjendës që mund të kenë implikim ligjor;
1.4.3. Rishikimi në aspektin ligjor i rregulloreve dhe politikave që shqyrtohen në Bordin e RTK-së;
1.4.4. Hartimi i vendimeve, konkluzave dhe rekomandimeve si dhe përgatitja e tyre për nënshkrim nga Bordi i RTK-së;

Neni 9
Grupi Këshillues i Publikut

1. Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut (GKP), emërohen nga Bordi i RTK-së në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, nëpërmes konkursit publik;
2. GKP përbëhet nga tre shqiptarë, një serb dhe një pjesëtar nga komunitetet tjera, të cilët janë të regjistruar si banorë të Kosovës dhe kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë. Tre anëtarë të tij duhet të jenë kompetent në lëminë që është me rëndësi për punën e këtij Grupi Këshillues;
3. Anëtarët e GKP-së zgjidhen me mandat prej dy vitesh me mundësi të riemërimit nga Bordi edhe për një mandat;
4. Anëtarët e GKP-së nga radhët e veta emërojnë dhe shkarkojnë Kryesuesin me shumicë të thjeshtë votash;
5. Kuorumi i mbledhjeve të GKP-së arrihet me 3 anëtarë kurse puna e tyre rregullohet me Ligjin për RTK-në;
6. Grupi Këshillues i Publikut shqyrton:
   a) Vërejtjet dhe sugjerimet e shikuesve dhe dëgjuesve;
   b) E këshillon Bordin e RTK-së për çështjet e caktuara lidhur me programet e RTK-së;
   c) GPK e kryen funksionin e vet dhe kryen punë të tjera të caktuara me Ligjin për RTK-në dhe Statutin e RTK-së;
   d) Zgjedhja e GKP-së bëhet përmes konkursit publik, sipas rregulloreve respektive për rekrutim;
   e) Bordi krijon një Komision ad-hoc përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së GKP-së;
   f) Bordi emëron anëtarët e GKP-së pas propozimit të Komisionit ad-hoc.
   g) Anëtarët e GKP-së kanë të drejtë në kompensim, të përcaktuar nga Bordi i RTK-së;

Neni 10
Njësia e Auditimit të Brendshëm

1. Auditimi i brendshëm i RTK-së kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB).
2. NJAB-i i raporton Bordit në baza tremujore dhe Komitetit të Auditimit të Brendshem të RTK-së në baza mujore
3. Bordi i RTK-së zgjedh auditorët e NJAB-it nëpërmjet konkursit publik, sipas rregulloreve respektive për rekrutim;
4. NJAB-i ka udhëheqësin e saj, i cili njëkohësisht është edhe Auditor i Brendshëm;
5. Puna e NJAB-it rregullohet me statut dhe me aktet tjera ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës.

Neni 11
Komiteti i Auditimit të Brendshëm

1. Bordi i RTK-së themelon Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB), i cili ka këto funksione:
   a) Siguron mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit;
   b) Siguron pavarësinë e Auditorit të Brendshëm (NJAB);
   c) Vlerëson përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
   d) Siguron që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;
   e) Rekomandon Bordin mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit;
   f) Pranon raportet e auditimit të brendshëm me rekomandime, i shqyrton ato dhe i përcjell në Bord;
   g) Përbërja e Komitetit të Auditimit rregullohet sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
   h) Dy të tretat e anëtarëve të komitetit duhet të jenë të jashtëm dhe zgjedhen për mandat 3 vjeçar me të drejtë për riemërim edhe për një mandat shtesë;
   i) Zgjedhja e anëtarëve të jashtëm të komitetit bëhet përmes konkursit publik, sipas rregulloreve respektive për rekrutim;
   j) Bordi emëron anëtarët e brendshëm me shumicë të thjeshtë votash;
   k) Komiteti i auditimit zgjedh kryesuesin e vet me shumicë votash;
   l) Anëtarët e komitetit kanë të drejtë në kompensim, të përcaktuar nga Bordi i RTK-së;
   m) Puna e Komitetit rregullohet me statut dhe me aktet tjera ligjore dhe nënligjore.

Neni 12
Paraqitja ne media dhe komentimi në publik i punës së Bordit

1. Anëtarët e Bordit të RTK-së nuk bëjnë postime, shpërndarje, pëlqime lidhur me zhvillimet politike, polemikave politike ose temave tjera të ndjeshme të cilat cenojnë paanshmërinë e RTK-së.
2. Bordi i RTK-së mund të paraqitet në media për çështje që kanë të bëjnë me RTK-në pas konsultave të brendshme.
3. Anëtarët e Bordit të RTK-së mund të paraqiten në media për çështje që nuk kanë të bëjnë me RTK-në duke u siguruar që nuk cenojnë integritetin, imazhin, paanshmerinë dhe profesionalizmin e RTK-së.

Neni 13
Shfrytëzimi i aseteve të RTK-së

1. Bordi i RTK-së ka të drejtë të shfrytëzojë asetet e RTK-së për kryerjen e aktiviteteve zyrtare, si në vijim:
   a) Pajisjet teknike;
   b) Zyrë dhe inventar;
   c) Parkingun e RTK-së;
   d) Telefonat fiks dhe mobilë;
   e) Automjetet e RTK-së.

Neni 15
Dispozitat kalimtare

Bordi i RTK-së ka të drejtën e ndryshimit, plotësimit dhe ndërrimit të kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi.

22 Shtator 2023
Besnik Boletini

Kryetar i Bordit të RTK-së